



Pranuar / Dorezuar Prilimjen/Prilato Received/Delivery		31. 12	2021	1	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix		Sasia Kolicina Quantity	
SKOMSHCK	6446/2021			1/4	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.990/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Jeton Koca dhe Eshref Shabani-anëtar dhe Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, sipas Aktgjykimit me numër A.nr.131/20, të datës 22.11.2021, të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.730/2019 të datës 22.11.2019, të parashtruar nga ankuesja [redacted] me adresë banimi rruga "Fehmi Agani", nr.34/6, Komuna e Prishtinës kundër organit të punësimit/Ministria e Shëndetësisë, në çështjen juridike "shkelje e të drejtës në pagë" duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datën 30.12.2021, mori këtë:

V E N D I M

HEDHET poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.730/2019 e datës 22.11.2019, e parashtruar nga ankuesja [redacted]

A r s y e t i m

Ankuesja [redacted], e punësuar në Ministrinë e Shëndetësisë, sipas akt emërimit me numër Nr.162 të datës 09.10.2017 në pozitën "Inspektor i farmacisë", pranë Departamentit të Inspektoratit të Farmacisë, me datën 08.10.2019 ka parashtruar ankesë për nivelizimin e pagës tek Udhëheqësja e Departamentit të Zyrës Ligjore në Ministrinë e Shëndetësisë.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Ministrisë së Shëndetësisë me datën 11.10.2019 ka njoftuar ankuesen se pas hyrjes në fuqi të Ligjit nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, nuk ka legjitimitet për shqyrtimin e ankesës dhe e ka udhëzuar që sipas dispozitave ligjore në fuqi të këtij ligji, t'i drejtohen drejtpërdrejtë Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Ankuesja sipas këtij referimi, me datën 22.11.2019 ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 5496/2019 të përfshirë si grup ankuesish, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore lidhur me cenimin e të drejtave të nëpunësve civil që të gjithë inspektorët farmaceutik të punësuar brenda Inspektoratit Farmaceutik për Produkte dhe Pajisje Medicinale do duhej të paguheshin njëjtë meqenëse kryejnë punë të njëjtë në Ministrinë e Shëndetësisë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datën 27.11.2019, e ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankueses në Ministrinë e Shëndetësisë. Me datën 05.12.2019, Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Ministria e Shëndetësisë me shkresat e bashkangjitura.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga muaji janar i vitit 2019 deri me datën 08.10.2020, ka qenë jo funksional dhe nuk ka vendosur për ankesën e ankueses, ndërsa me datën 12.12.2019, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka njoftuar ankuesen për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës duke e udhëzuar se mund ti ndjek procedurat e mëtejme dhe se në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ mund ta filloj procedurën gjyqësore pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative me datën 22.11.2021 ka nxjerrë Aktgjykimin me numër A.nr.130/2020, sipas të cilit ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses, duke e anuluar njoftimin e datës 12.12.2019 të KPSHMCK-se dhe ka obliguar Këshillin që në afat prej tridhjetë (30) ditësh të vendos lidhur me ankesën e ankueses me numër A.nr.730/2019 të datës 22.11.2019.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, me qëllim të vërtetimit të drejtë të gjendjes faktike dhe për vendosje meritore ka administruar këto prova: Ankesa e ankueses me numër të protokollit 5496/2019 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Njoftim i datës 11.10.2019 nga Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Shëndetësisë ; Listë e pagave për ankueset; Akt emërim me numër Nr.162 i ankueses [redacted] i datës; Deklaratë e ankueses e datës 09.10.2017; Akt emërim me numër Nr.Prot.2512 i ankueses [redacted] i datës 31.10.2013; Akt emërim me numër Nr.Prot.2514 i ankueses [redacted] i datës 31.10.2013 së bashku me përshkrimin e detyrave të punës; Ankesë e datës 08.10.2019 e ankuesve në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Përgjigje në ankesë e datës 15.08.2019; Vendim mbi themelimin e Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i datës 26.07.2019; Ankesë e ankuesve për nivelizim të pagës e datës 10.07.2019 në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Kërkesë për nivelizim të pagës nga ankuesit e datës 14.02.2018; Ankesë e datës 21.11.2017 e ankuesve e parashtruar për Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Kërkesë për implementimin e 30% të pagës e datës 09.12.2010; Kërkesë e datës 30.05.2016 për aprovim të procedurave të pagesës së rrezikshmërisë së stafit të Inspektoratit shëndetësor; Memorandumi i mirëkuptimit ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave i datës 01.01.2010; Shkresë zyrtare e datës 02.07.2010 nga Ministria e Shëndetësisë për Ministrinë e Administratës Publike; Letër e përbashkët e datës e datës 16.02.2010; Vendim i datës 09.09.2015 për rishikimin e ndarjes se shtesave të cilat realizohen nga buxheti i Republikës së Kosovës; Shkresë zyrtare e datës 08.02.2010 nga Ministri i Shëndetësisë; Propozim vendim i datës 05.02.2010 nga Kryeministri i

Kosovës; Lista e pagave për muajin shtator të vitit 2017; Kërkesa për përgjigje në ankese e datës 27.11.2019 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigja në ankesë e datës 05.12.2019 nga Ministria e Shëndetësisë me shkresat e bashkangjitura të lëndës; Akt emërim me numër Nr.165 i ankuesit [redacted] i datës 09.10.2014 se bashku me deklaratën; Akt emërim me numër Nr.Prot.192 i ankuesit [redacted] i datës 23.06.2019 së bashku me deklaratën; Akt emërim me numër Nr.160 i ankueses [redacted] i datës 09.10.2017 së bashku me deklaratën; Akt emërim me numër Nr.161 i ankuesit [redacted] i datës 09.10.2017 se bashku me deklaratën; Akt emërim me numër Nr.164 i ankuesit [redacted] Azemi i datës 09.10.2019 se bashku me deklaratën dhe certifikatën për evidencën penale; Lista mbi kartelat e nëpunësve civil për [redacted]

[redacted] Mustafa për periudhën janar-nëntor 2019; Njoftim i datës 12.12.2019 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Njoftim i datës 07.07.2021 lidhur me ankesën A.nr.730/2019 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Njoftim i datës 07.07.2021 lidhur me ankesën me numër A.nr.132/2020 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Aktgjykim me numër A.nr.129/2020 i datës 05.07.2021 i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative; Aktgjykim me numër A.nr.128/20 i datës 02.09.2021 i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative ; Aktgjykim me numër A.nr.127/20 i datës 03.09.2021 i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative; Aktgjykim me numër A.nr.131/20 i datës 22.11.2021 i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative; Evidenca mbi pranimin e aktit e datës 11.10.2019.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankueses [redacted], është e pa lejuar, sepse:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar provat e bashkangjitura në lëndë të dërguara si nga organi i punësimit ashtu edhe ankuesja, ka konstatuar se: ankuesja [redacted] ankesën lidhur me nivelizimin e pagës e ka parashtruar me datën 08.10.2019 në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Shëndetësisë. Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Shëndetësisë me datën 11.10.2019 ka njoftuar ankuesen se pas hyrjes në fuqi të Ligjit nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, nuk ka legjitimitet për shqyrtimin e ankesës dhe e ka udhëzuar që sipas dispozitave ligjore në fuqi të këtij ligji t'i drejtohen drejtpërdrejtë Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës. Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në bazë të dëshmive të ofruara nga Ministria e Shëndetësisë, ka konstatuar se njoftimin e Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Shëndetësisë e ka pranuar me datë 11.10.2019 ndërsa ankesën në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e ka parashtruar me datën 22.11.2019 e që është jashtë afatit ligjor të përcaktuar me nenin 127 paragrafin 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: "**Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve, nga data kur është njoftuar për aktin administrativ**", prandaj në kuptim të kësaj dhe nenit 18 paragrafit 1 nën paragrafit 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ankesa e ankueses është e pa lejuar. Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka vlerësuar se ankuesja nuk e ka shfrytëzuar të drejtën e ankimit brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës respektivisht



nga data 11.10.2019 kur ankuesja e ka pranuar njoftimin e datës 11.10.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Shëndetësisë .

Andaj, duke u bazuar në nenin 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A.nr.990/2021

Ardita Perçuku-Shyti

Ardita Perçuku
Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Malsore Gashi
Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet

- Ankueses [REDACTED]
- Gjykatës Themelore ne Prishtine Departamenti për Çështje Administrative, Gjyqtares Vjollca Limani
- Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Shëndetësisë;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Shëndetësisë dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

